



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF
KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE / MUNICIPAL GJILAN /
GILAN BELEDIYESI



Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit

RAPORTI KRAHASUES
(për tërë mandatin qeverisës, katërvjeçar)

A. Mes qeverisjes paraprake (2018-2021) dhe qeverisjes aktuale (2022-2025)

Raporti krahasues i përformancës së DUPMM, sipas parametrave më të rëndësishëm krahasues, **në mes të qeverisjes së kaluar** (2018, 2019, 2020 dhe deri në fund të muajit tetor 2021) **dhe aktuales**, gjatë tërë mandatit qeverisës (2022, 2023, 2024 dhe deri në fund të muajit tetor 2025). DUPMM nga viti 2018 deri në fund të tetorit të vitit 2025 ka performuar si në vijim:

I. Aktet e lëshuara:



- Viti 2018 = 1,426 akte
- Viti 2019 = 894 akte
- Viti 2020 = 448 akte
- Viti 2021 (deri në fund të muajit tetor) = 456 akte

Gjithsej: 3,224 akte

- Viti 2022 = 923 akte
- Viti 2023 = 1,544 akte
- Viti 2024 = 1,367 akte
- Viti 2025 (deri në fund të muajit tetor) = 1,075 akte

Gjithsej: 4,909 akte

Nga të dhënat e prezantuara konstatohet se në DUPMM, gjatë qeverisjes aktuale, për të njëjtin interval kohor raportues, **janë trajtuar 1,685 akte më shumë se sa gjatë qeverisjes së kaluar, shprehur në % = 152%.**





II. Mjetet financiare të inkasuara:

- Viti 2018 = 770,356 euro
- Viti 2019 = 834,353 euro
- Viti 2020 = 619,446 euro
- Viti 2021 (deri në fund të muajit tetor) = 670,669 euro

Gjithsej: 2,894,824 euro

- Viti 2022 = 543,218 euro
- Viti 2023 = 1,803,539 euro
- Viti 2024 = 1,293,858 euro
- Viti 2025 (deri në fund të muajit tetor) = 1,060,451 euro

Gjithsej: 4,701,066 euro



Nga të dhënat e prezentuara konstatohet se në DUPMM, gjatë qeverisjes aktuale, për të njëjtin interval kohor raportues, janë inkasuar mjete financiare në vlerë = 1,806,242 euro më shumë se sa gjatë qeverisjes së kaluar, shprehur në % = 162 %.

Duhet potencuar faktin se vlera e inkasimit do të ishte akoma, shumë më e lartë, sikur se Taksa dhe Tarifa për lëshimin e Lejeve Ndërtimore të ishte ndyshuar, ashtu si është e paraparë me ligj, si dhe të ishte aplikuar Tarifa për ndikim në infrastrukturë, e cila deri më sot nuk është aplikuar.

Kto vlera të inkasimit janë arritur bazuar në Taksën dhe Tarifën për rritjen e dendësitetit, sipas Rregullores (K.GJ) NR.03/2018 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për Taksa, Ngarkesa dhe Gjoha Komunale e cila është miratuar nga Kuvendi i Komunës së Gjilanit, më datën 22.03.2018, e cila nuk ka ndryshuar gjerë më tani për shkak të mungesës së numrit të nevojshëm të këshilltarëve komunal nga kualicioni qeverisës.

Interasant është të potencohet fakti se vetëm gjatë muajve nëntor dhe dhjetor të vitit 2021, periudhë kjo e tranzicionit të pushtetit nga qeverisja e kaluar në qeverisjen aktuale, nga DUPMM:

1. Janë lëshuar leje ndërtimore për sipërfaqe të ndërtimit 176,899 m², që është për 76,665 m² më shumë se për 10 muajt paraprak të vitit 2021, apo shprehur në % = 176%

2. Janë inkasuar mjete financiare në vlerë = 882,331 euro, që është për 211,662 euro, më shumë se për 10 muajt paraprak të vitit 2021, apo shprehur në % = 132%.

Këto shifra janë një tregues që e bën të dyshimtë rregullshmërinë e procedurave dhe zbatimin e ligjeve.



B. Në mes të planifikimit dhe realizimit

Raporti krahasues i përformancës së DUPMM, sipas parametrave më të rëndësishëm krahasues, **në mes planifikimit dhe realizimit**, gjatë tërë mandatit qeverisës (2022, 2023, 2024 dhe deri në fund të muajit tetor 2025).

I. Aktet e lëshuara:

- Viti 2022 = 923 akte
- Viti 2023 = 1,544 akte
- Viti 2024 = 1,367 akte
- Viti 2025 (deri në fund të muajit tetor) = 1,075 akte

Gjithsej: 4,909 akte



II. Mjetet financiare:

- Të planifikuara:


- Viti 2022 = 850,000 euro
- Viti 2023 = 920,000 euro
- Viti 2024 = 860,000 euro
- Viti 2025 = 860,000 euro


Gjithsej: 3,490,000 euro

- Të inkasuara:

- Viti 2022 = 543,218 euro
- Viti 2023 = 1,803,539 euro
- Viti 2024 = 1,293,858 euro
- Viti 2025 (deri në fund të muajit tetor) = 1,060,451 euro

Gjithsej: 4,701,066 euro





*Nga të dhënat e prezantuara konstatohet se në DUPMM, gjatë tërë mandatit të qeverisjes aktuale (vetëm deri në fund të muajit tetor 2025, dy muaj para përfundimit të vitit), **janë inkasuar mjete financiare në vlerë =1,211,066 euro më shumë** se sa që janë planifikuar për katër vitet të qeverisjes aktuale (2022 + 2023 + 2024 + 2025), **shprehur në % = 135%**.*

Këto rezultate janë kontribut i përkushtimit dhe bashkëpunimit sinergjik të zyrtarëve të Drejtorisë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit, si dhe Drejtorisë së Inspeksionit e cila ka ndikuar në reduktimin në maksimum të ndërtimeve pa Leje Ndërtimi, për çka i përgëzoj dhe falënderoj.

Më: 07.11.2025
Gjilan

Drejtori:
Ali Arifi